



Nr. i Prot. 15839 4.8.2025

Nr. i Prot. 21 / 2025

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET
NJËSISË SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE
DHE FUQIZIMIN E GRAVE
DHE
BASHKISË SHKODËR

Ky Memorandum Mirëkuptimi ("MM") lidhet midis Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave ("UN Women") dhe Bashkisë Shkodër ("Partneri"). Në vijim, UN Women dhe Bashkia Shkodër cilësohen secila më vete si "Pala" dhe së bashku si "Palët."

DUKE QENË SE UN Women është një organ në varësi të Kombeve të Bashkuara me mandatin për të arritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave;

DUKE QENË SE UN Women njih rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me partnerë për arritjen e mandatit dhe objektivave strategjike të tij;

DUKE QENË SE Bashkia Shkodër ushtron funksionin e saj si organ i vetëqeverisjes vendore që zbaton Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 në përputhje me nenin 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";

1. **DUKE QENË SE** Partneri mbështet mandatin e UN Women, sikurse përcaktohet në rezolutën 64/289 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe në Planin Strategjik të UN Women për vitet 2018-2021, miratuar nga Bordi Ekzekutiv i tij më 30 gusht 2017, si dhe në Planin Strategjik të UN Women për vitet 2022-2025, miratuar nga Bordi Ekzekutiv i tij më 16 gusht 2021, me fokus të posaçëm mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, dhe fuqizimin ekonomik të grave;

BAZUAR NË SA MË LART, Palët bien dakord të bashkëpunojnë për sa vijon:

Neni I

Objekti i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi, bashkë me Shtojcat e tij renditur më poshtë, të cilat janë pjesë përbërëse integrale e tij, përcakton termat dhe kushtet e bashkëpunimit ndërmjet Palëve:
 - a. Shtojca I: Përshkrimi i Aktiviteteve
 - b. Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit (“Kushtet e Përgjithshme”).
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe çdo marrëveshje vijuese e lidhur në bazë të tij, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes midis palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendësojnë të gjitha komunikimet e tjera me gojë ose me shkrim për këtë temë.

Neni II

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët pajtohen të bashkëpunojnë në mirëbesim për arritjen e objektivave të përbashkëta të tyre, të cilat janë:

Fusha A: Forcimi i kapaciteteve dhe angazhimi i autoriteteve dhe palëve përkatëse të interesit në nivel vendor për zbatimin e politikave dhe planeve të harmonizuara me standardet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, duke rritur në të njëjtën kohë ndërgjegjësimin e komunitetit për të drejtat e grave dhe stereotipet gjinore që vazhdojnë të ekzistojnë dhe duke përmirësuar aksesin në shërbime dhe mundësi social-ekonomike për gratë e mbijetuara të dhunës.

Fusha B: Forcimi i njohurive të palëve të interesit për pikat e hyrjes dhe strategjitë për rritjen e aksesit të grave në mundësi të fuqizimit ekonomik, duke i pajisur në të njëjtën kohë gratë dhe palët e interesit në zonat rurale me kapacitetet, instrumentet dhe burime të tjera për të shfrytëzuar zinxhirët e vlerës (ZV) që përmirësojnë mundësitë e punësimit, të ardhurat, sigurinë ushqimore, standardet e ushqyerjes dhe stabilitetin ekonomik.

Fusha C: Pajisja e grave sipërmarrëse në sektorin e turizmit me aftësi dhe njohuri për t'u përshtatur më mirë me nevojat e udhëtareve femra, duke promovuar një turizëm të sigurt dhe miqësor për gratë, nxitja e një qasjeje me ndjeshmëri gjinore në sektorin e

turizmit dhe përmirësimi i sigurisë dhe mirëqenies në vendin e punës për gratë e punësuar në këtë industri.

2. Për realizimin e objektivave të përbashkët të përshkruar më lart, Palët pajtohen të kryejnë aktivitetet e renditura në Përshkrimin e Aktiviteteve ("aktivitetet"), të cilat kohë pas kohe mund të modifikohen me marrëveshje me shkrim midis Palëve.

Neni III

Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Palët mund të negociojnë në mirëbesim termat e ndonjë marrëveshjeje vijuese që mund të jetë e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve. Ato marrëveshje do të specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë dhe kostot ose shpenzimet që lidhen me aktivitetet dhe si do të mbulohen ato nga Palët. Ato marrëveshje do të përfshijnë përmes referimit termat e të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
2. Palët pajtohen që secila të caktojë një menaxher të marrëdhënieve, për monitorimin afatgjatë të këtij partneriteti. Gjithashtu, Palët mund të vendosin të krijojnë grupe pune të përbërë nga përfaqësues të secilës Palë, që do të jenë përgjegjës për monitorimin e zhvillimit dhe të zbatimit të aktiviteteve.

Neni IV

Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve

Palët bien dakord të shkëmbejnë informacion dhe dokumente relevante, sipas nevojës për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në varësi të kufizimeve dhe masave që mund të kërkojnë nga secila Palë për ruajtjen e natyrës konfidenciale të disa informacioneve dhe dokumenteve.

Neni V

Njohja

1. Në varësi të paragrafit 4 të Shtojcës II mbi Kushtet e Përgjithshme, Palët mund të njohin dhe t'i bëjnë të njohur publikut këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe informacione në lidhje me aktivitetet, në përputhje me politikat aktuale të secilës palë dhe me miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.
2. Në aktivitete publike, konferenca për mediat, ose mbledhje të çdo lloji, përfaqësuesit e secilës Palë mund të flasin për bashkëpunimin në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, por rreptësisht vetëm në emër të vet. Çdo njoftim për mediat i njërës

Palë në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi ose me aktivitetet e ndërmarra të përshkuara më poshtë, do t'i jepen përgjegjësit të komunikimeve të Palës tjetër për shqyrtim dhe për dhënien e pëlqimit, të paktën pesë (5) ditë pune para lëshimit të njoftimit.

Neni VI

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të bëjnë përpjekjet më të mëdha të mundshme për të zgjidhur në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje, kundërshti, ose pretendim që lind nga ky Memorandum Mirëkuptimi.
2. Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim ndërmjet Palëve që lind nga ky Memorandum Mirëkuptimi dhe që nuk zgjidhet në mënyrë miqësore në përputhje me paragrafin pararendës, do t'i dorëzohet, me kërkesë të çdonjërës Palë, një tribunali të përbërë nga tre arbitra ("Tribunali"). Secila Palë do të caktojë një arbitër dhe, dy arbitrat e caktuar në këtë mënyrë do të caktojnë një arbitër të tretë, që do të jetë kryesuesi i Tribunalit. Në qoftë se arbitri i tretë nuk është emëruar brenda 15 ditësh prej caktimit të dy arbitrave, secila Palë mund t'i kërkojë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të caktojë arbitrin në fjalë. Tribunali përcakton procedurat e veta, me kusht që çdo dyshe arbitrash të përbëjë kuorum për të gjitha qëllimet, dhe të gjitha vendimet duhet të merren me pajtimin e çdo dy arbitrave. Shpenzimet e Tribunalit paguhën nga Palët, sipas vlerësimit të Tribunalit. Vendimi i arbitrave duhet të përmbajë një deklaratë të arsyeve ku bazohet dhe do të jetë vendim i formës së prerë dhe i detyrueshëm për Palët.
3. Pavlefshmëria apo moszbatueshmëria e cilësdos prej dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të Memorandumit të Mirëkuptimit.
4. Në rast konflikti ose mospërputhjes midis versioneve në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, versioni në anglishte është ai autoritar.

Neni VII

Njoftimet dhe adresat

Çdo njoftim që jepet në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, bëhet me shkrim dhe do të konsiderohet se është bërë kur t'i jetë dorëzuar Palës në adresën e specifikuar më poshtë:

Për UN Women: Michele Ribotta, Përfaqësues i UN Women, Shqipëri
Rr. Skënderbej, P.8, Kati i dytë, Ap. 29, 30, 31, Tiranë, Shqipëri.

Për Partnerin: Benet Beci, Kryetar i Bashkisë Shkodër
I përfaqësuar me vendim delegimi Nr.226 datë 30.06.2025 nga Zv/Kryetar Teuta Qyteza
Rruga 13 Dhjetori, Shkodër, Shqipëri.

Neni VIII

Kohëzgjatja, përfundimi, ndryshimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja Palët, pas të cilit do të mbetet në fuqi për një periudhë trevjeçare, përveç nëse përfundohet para kohe nga secila Palë në përputhje me paragrafin 2 më poshtë. Palët mund të pajtohen të shtyjnë afatin e Memorandumit të Mirëkuptimit për periudha vijuese dyvjeçare.
2. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi sipas diskrecionit të vet dhe do të përpiqet t'i japë tre muaj njoftim paraprak me shkrim Palës tjetër. Po kështu, mund të përfundohet çdo marrëveshje vijuese e lidhur në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në përputhje me dispozitën e përfundimit të përfshirë në ato marrëveshje. Në rast të tillë, Palët marrin masat e nevojshme për të siguruar që aktivitetet sipas kësaj marrëveshjeje dhe/ose çdo marrëveshjeje vijuese të përfundojnë menjëherë dhe me rregull.
3. Dispozitat e mëposhtme do të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit, apo në rast të përfundimit të parakohshëm të këtij Memorandumi Mirëkuptimi:
 - (a) Neni IV (Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve), Neni VI (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve);
 - (b) Paragrafi 3 (Përgjegjësia), paragrafi 4 (përdorimi i emrit, shkurtesës dhe emblemës), paragrafi 5 (privilegjet dhe imunitetet) dhe paragrafi 10 (pronësia intelektuale) i Kushteve të Përgjithshme; dhe
 - (c) Në rastin kur Partneri është organizatë ndërqeveritare që nuk bën pjesë në sistemin e OKB-së, paragrafi 9 (Zhdëmtimi) i Kushteve të Përgjithshme.
4. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me pajtim të ndërsjellë të Palëve, të dhënë me shkrim.

NË PRANI TË TYRE, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve vënë nënshkrimet më poshtë.

Për UN Women:

Michele RIBOTTA

Përfaqësues,

UN Women Shqipëri


28/7/2025

Data

Për Bashkinë Shkodër

Teuta Qyteza

Zv/Kryetar i Bashkisë,

Bashkia Shkodër




Data



Shtojca I Përshkrim i aktiviteteve

Në varësi të disponueshmërisë së burimeve financiare, aktivitetet në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund të përfshijnë sa më poshtë:

Fusha A: Forcimi i kapaciteteve dhe angazhimi i autoriteteve dhe palëve përkatëse të interesit në nivel vendor për zbatimin e politikave dhe planeve të harmonizuara në standardet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mbi BGJFG, duke rritur në të njëjtën kohë ndërgjegjësimin e komunitetit për të drejtat e grave dhe stereotipet gjinore që vazhdojnë të ekzistojnë, si dhe përmirësimi i aksesit në shërbime dhe mundësi social-ekonomike për gratë që i kanë mbijetuar dhunës.

- Miratimi dhe zbatimi i Kartës Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në jetën vendore dhe hartimi i Planit të Veprimit Vendor, duke ndërtuar mbi praktikën e mira nga bashkitë e tjera që mbështeten nga UN Women.
- Mbështetja e monitorimit të zbatimit në nivel vendor të kornizave të politikave kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare (përfshirë KEGJFDHG-në, Platformën e Pekinit, etj.) në lidhje me zhvillimin rural nga këndvështrimi i BGJFG.
- Përgatitja dhe zhvillimi i fushatave edukuese dhe ndërgjegjësuere (përfshirë për Ditën Ndërkombëtare të Grave, Ditën Ndërkombëtare të Grave Rurale, 16 Ditët e Aktivizmit, etj.) për të drejtat e grave, ndër të cilat të drejtat pronësore të tyre, aksesin në financim dhe fonde për gratë dhe vajzat në zonat rurale.
- Lehtësimi i dialogut ndërmjet grave në zonat rurale dhe vendimmarrësve, si dhe pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse.
- Forcimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për mbështetjen e drejtpërdrejtë të të mbijetuarave të DHBGJ/DHF, përfshirë përmes ofrimit të këshillimit psiko-social, ndihmës ligjore falas, strehëzave, etj., për zgjerimin e shërbimeve të tyre në më shumë zona rurale, me fokus të veçantë mbi gratë nga grupet e marginalizuara.
- Përgatitja dhe zbatimi i aktiviteteve të ri-integrimit social-ekonomik në bashkitë e synuara, për të siguruar ri-integrimin afatshkurtër dhe afatgjatë të të mbijetuarave të dhunës.

Fusha B: Forcimi i njohurive të palëve të interesit për pikat e hyrjes dhe strategjitë për rritjen e aksesit të grave në mundësi të fuqizimit ekonomik, duke i pajisur në të njëjtën kohë gratë dhe palët e interesit në zonat rurale, me kapacitetet, mjetet dhe burimet për

shfrytëzimin e zinxhirëve të vlerës (ZV) që përmirësojnë mundësitë e punësimit, të ardhurat, sigurinë ushqimore, standardet e ushqyerjes dhe stabilitetin ekonomik.

- Kryerja e analizës specifike vendore dhe me ndjeshmëri gjinore të zinxhirëve të vlerës për identifikimin e potencialeve ekonomike në zonat, zinxhirët kryesorë të vlerës me potencial për zhvillim, rolin e grave dhe burrave në këta zinxhirë të vlerës, dhe barrierat që kufizojnë suksesin e grave dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës, si dhe të hartohen ndërhyrjet përkatëse.
- Zbatimi i ndërhyrjeve me ndjeshmëri gjinore në zinxhirët e vlerës bazuar në konstatimet e analizës.
- Lehtësimi i pjesëmarrjes së grave sipërmarrëse në udhëtime studimore dhe shkëmbime brenda dhe jashtë vendit.
- Mbështetja e grave sipërmarrëse në bujqësi dhe e bizneseve të reja të drejtuara nga gratë, përfshirë ato aktive në ekonominë e gjelbër dhe qasje të favorshme klimatike, përmes ofrimit të këshillimeve të posaçme për to dhe skemave të nëngranteve.

Fusha C: Pajisja e grave sipërmarrëse në sektorin e turizmit me aftësi dhe njohuri për t'u përshtatur më mirë me nevojat e udhëtareve femra, duke promovuar një turizëm të sigurt dhe miqësor për gratë, nxitja e një qasjeje me ndjeshmëri gjinore në sektorin e turizmit dhe përmirësimi i sigurisë dhe mirëqenies në vendin e punës për gratë e punësuar në këtë industri.

- Mbështetja e grave sipërmarrëse të përzgjedhura në sektorin e turizmit në Shkodër përmes ndërhyrjeve për forcimin e kapaciteteve, përfshirë këshillimet e posaçme, me qëllim zhvillimin e produkteve turistike të dedikuara për gratë që udhëtojnë vetëm dhe grupet e udhëtimeve për gra.
- Mbështetja e grave sipërmarrëse të përzgjedhura në testimin dhe promovimin e këtyre produkteve të reja turistike.
- Kontributi në integrimin e perspektivës gjinore në sektorin e turizmit në Bashkinë Shkodër përmes nxitjes së dialogut dhe mundësive për shkëmbim njohurish për administratorët dhe pronarët e strukturave turistike.
- Lehtësimi i aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve në strukturat turistike (hotele, njësi agroturizmi) në Bashkinë Shkodër, me fokus në sigurinë dhe mirëqenien e punonjëseve gra, përfshirë fuqizimin e tyre përmes trajnimeve për vetëmbrojtje.

ROLI I BASHKISË SHKODËR:

- Të caktojë një pikë fokale teknike që do të lehtësojë bashkëpunimin në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
- Të sigurojë dokumentet informative, të dhënat dhe statistikat përkatëse në mbështetje të nismave për të cilat është rënë dakord nga të dyja Palët.
- Të japë mendime për hartimin e programit të trajnimeve, takimeve dhe aktiviteteve të tjera konsultuese, si dhe për materialet dhe pjesëmarrësit/përfitueset e pritshme.
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personelit të bashkisë në aktivitete, trajnime, këshillime, grupe pune dhe shkëmbime të organizuara në kuadër të nismave për të cilat është rënë dakord nga të dyja Palët.
- Të kontribuojë si partner kryesor, sipas nevojës, në aktivitetet e organizuara në kuadër të nismave për të cilat është rënë dakord nga të dyja Palët.
- Të lehtësojë organizimin e tryezave të ndryshme për konsultime, të takimeve vlerësuese dhe dëgjësive publike me grupe të ndryshme, si edhe të krijojë partneritete të mira dhe të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të nevojshëm, partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe përfituesve në këto lloje aktivitetsesh.
- Të luajë rol aktiv dhe të bashkëpunojë nga afër me partnerët përgjegjës të UN Women/kontraktorët dhe ekspertët.
- Të promovojë dhe lehtësojë miratimin dhe zbatimin e kuadrit ndërkombëtar dhe evropian që promovon barazinë gjinore në nivelin vendor, sidomos hartimin e Planit të Veprimit Vendor për Barazinë Gjinore në bashki.
- Të udhëheqë miratimin, zbatimin dhe raportimin e veprimeve të angazhuara në kuadër të PVVBGJ-së.
- Të kontribuojë aktivisht në forcimin e mekanizmit të koordinuar të referimit për të mbijetuarat e dhunës, përfshirë mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-së.
- Të promovojë, mbështesë dhe lehtësojë zbatimin e ndërhyrjeve me ndjeshmëri gjinore në zinxhirët e vlerës, duke siguruar mundësi të qëndrueshme për fuqizimin ekonomik të grave si pjesë e nismave të UN Women. Kjo përfshin mobilizimin e burimeve bashkiake për të mbështetur bizneset e drejtuara nga gratë, nxitjen e krijimit të rrjeteve dhe mundësive në treg, lehtësimin e aksesit në shërbimet publike, dhe integrimin e politikave me ndjeshmëri gjinore në planet/strategjitë e zhvillimit vendor. Krahas kësaj, të angazhohet për qëndrueshmërinë afatgjatë të këtyre përpjekjeve përmes planifikimit strategjik për fuqizimin ekonomik të grave dhe për një zhvillim ekonomik vendor përfshirës.
- Të promovojë dhe mbështesë aktivitete ndërgjegjësuëse brenda bashkive në lidhje me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, përfshirë përmes lehtësimit dhe ofrimit të aksesit në hapësirat publike, shoqatat vendore, ndër të tjera.

ROLI I UN WOMEN:

- Të ofrojë ekspertizë teknike, udhëzime dhe mbështetje për hartimin dhe llogaritjen e kostos së Planit të Veprimit Vendor për Barazinë Gjinore, për integrimin e barazisë gjinore dhe temave të tjera specifike që i japin përparësi grave dhe vajzave. Të ofrojë ekspertizë teknike për zhvillimin e një instrumenti monitorimi dhe raportimi për zbatimin e PVVBGJ-së.
- T'i ofrojë bashkisë ekspertizë teknike dhe këshillim për fuqizimin ekonomik dhe social afatgjatë të grave që jetojnë në zonat rurale.
- Të mbështesë fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të aktiviteteve (analizë dhe ndërhyrje) në lidhje me Zinxhirët e Vlerës me Ndjeshmëri Gjinore (ZVNGJ), për identifikimin e mundësive ekonomike; të promovojë rolin dhe kontributin e grave në zinxhirët e vlerës dhe sistemet e tregut; të mbështesë zhvillimin e mjedisit/kushteve të sigurt të punës për punësim dhe vetëpunësim, dhe për akses në treg; me synim zhvillimin e ekonomisë vendore dhe përmirësimin e jetesës.
- Të përgatisë dhe kryejë fushata edukuese dhe ndërgjegjësuere (përfshirë për Ditën Ndërkombëtare të Grave, Ditën Ndërkombëtare të Grave Rurale, 16 Ditët e Aktivizmit, etj.) lidhur me të drejtat e grave, ndër të cilat të drejtat pronësore, aksesin në financim dhe fonde për gratë dhe vajzat në zonat rurale.
- Të lehtësojë dialogun mes grave rurale dhe vendimmarrësve, ku ato të shprehin nevojat e tyre dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse.
- T'u japë mbështetje financiare dhe teknike OSHC-ve që ofrojnë shërbime mbështetëse posaçërisht për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë ndihmë ligjore dhe mbështetje psikosociale.
- Të ofrojë mbështetje për forcimin e mekanizmit të koordinuar të referimit që merret me rastet e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.
- Të përgatisë dhe/ose zbatojë aktivitete ri-integrimi në bashkitë e synuara për të siguruar ri-integrimin afatshkurtër dhe afatgjatë të të mbijetuarave të dhunës.
- Të mbështesë gratë sipërmarrëse në zonat rurale dhe bizneset e reja të drejtuara nga gratë, përfshirë ato aktive në ekonominë e gjelbër dhe qasje të favorshme klimatike, përmes ofrimit të këshillimeve të posaçme për to dhe skemave të nëngranteve..
- T'i ofrojë mbështetje teknike dhe ekspertizë personelit të bashkisë për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme të analizës gjinore për hartimin, planifikimin, dhe monitorimin e politikave vendore.

Shtojca II. Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit

1. **Kontributi financiar:** Aktivitetet do të zbatohen në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e secilës Palë, në varësi të disponueshmërisë së burimeve financiare të nevojshme. Çdo transferim fondesh mes Palëve do të jetë objekt i një marrëveshjeje më vete në përputhje me Nenin III.1 të Memorandumit të Mirëkuptimit.
2. **Statusi ligjor:**
 - a. Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi, ose që ka lidhje me të, nuk do të interpretohet se krijon një partneritet ligjor, ndërmarrje të përbashkët, punësim, agjenci, marrëveshje ekskluzive, apo çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngjashme midis Palëve.
 - b. Asnjëra Palë nuk ka të drejtë apo kompetencë të lidhë kontratë ose zotim në emër ose për llogari të Palës tjetër, ose të krijojë ose marrë përsipër detyrime të çfarëdo lloji, të shprehura apo të nënkuptuara, në emër të Palës tjetër, përveçse siç përcaktohet specifikisht në këtë Memorandum Mirëkuptimi.
 - c. Përveç nëse Palët pajtohen ndryshe, Partneri ose cilido person i punësuar prej tij, nuk do të konsiderohet si përfaqësues ose si zyrtar i UN Women dhe nuk do të ketë të drejtë për asnjë kompensim ose rimbursim.
3. **Përgjegjësia:** Secila Palë do të jetë përgjegjëse për veprimet ose mosveprimet e veta.
4. **Përdorimi i emrit, shkurtesës dhe emblemës:** Asnjëra Palë nuk do të përdorë emrin, shkurtesën ose emblemën e Palës tjetër, të njëjsteve në varësi dhe/ose filialeve të saj, pa miratimin paraprak, të dhënë shprehimisht me shkrim nga Pala tjetër për secilin rast. Në asnjë rast nuk do të jepet autorizim për emrin, shkurtesën ose emblemën e UN Women për qëllime tregtare ose për përdorim në ndonjë mënyrë që sugjeron miratimin e të produkteve ose shërbimeve të Partnerit nga UN Women.
5. **Privilegjet dhe imunitetet:** Partneri do të respektojë statusin e UN Women si organizatë ndërkombëtare publike e sistemit të Kombeve të Bashkuara. Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi, ose që ka lidhje me të, nuk do të konsiderohet si heqje dorë, e shprehur apo e nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve të UN Women.
6. **Respektimi i ligjit:** Partneri do të respektojë ligjet e zbatueshme për të. Partneri nuk do të lejojë asnjë përfaqësues ose zyrtar të UN Women që të marrë përfitime të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta nga ky Memorandum Mirëkuptimi apo nga ndonjë marrëveshje vijuese ndërmjet Palëve.
7. **Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve:** Partneri nuk do të kalojë, transferojë, premtojë ose disponojë në ndonjë mënyrë tjetër këtë Memorandum Mirëkuptimi apo cilëndo pjesë të tij, ose ndonjë prej të drejtave, pretendimeve ose detyrimeve sipas të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, përveçse me miratimin paraprak me shkrim të UN

Women. Çdo kalim, transferim, premtim apo formë tjetër disponimi e paautorizuar nuk do të ketë fuqi detyruese për UN Women.

8. **Mosheqja dorë:** Heqja dorë prej një Pale nga ndërmarrja e veprimit kundër shkeljes së një dispozite të këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të jetë dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga ndërmarrja e veprimit kundër shkeljeve të tjera të asaj dispozite ose të dispozitave të tjera të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Fakti që një Palë nuk ndërmerr veprim për të kërkuar zbatimin e një dispozite të këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk përbën heqje dorë prej saj apo prej dispozitave të tjera të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Çdo heqje dorë duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga Pala kundër së cilës ndërmerret veprimi.
9. **Zhdëmtimi:** Në qoftë se Partneri është një organizatë ndërqeveritare që nuk bën pjesë në sistemin e OKB-së, Partneri nuk do të ngrejë padi dhe do të mbrojë dhe do të zhdëmtojë UN Women kundrejt padive, pretendimeve, kostove dhe detyrimeve që rezultojnë nga mosmarrëveshjet për pronësi intelektuale ose mosmarrëveshje të tjera që ndodhin në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, të cilat janë shkaktuar prej veprimeve ose mosveprimeve të Partnerit, përfaqësuesve ose punonjësve të tij.
10. **Pronësia intelektuale:** Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk u jep Palëve të drejtën të përdorin materiale që i përkasin ose që janë krijuar prej Palës tjetër. Secila Palë do të mbajë pronësinë intelektuale mbi të gjitha materialet e hartuara dhe prodhuara prej saj. Partneri pranon parimin se Kombet e Bashkuara zotëron prona intelektuale të gjeneruara prej aktiviteteve programatike dhe të projekteve të Kombeve të Bashkuara për të mirën e përbashkët dhe se shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë të drejtën e përdorimit jokomercial të rezultateve të këtyre aktiviteteve programatike dhe të projekteve. Palët pajtohen që, përveç nëse parashikohet ndryshe në rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e UN Women ose në marrëveshjet e lidhura ndërmjet tij dhe qeverisë së shtetit pritës dhe/ose partnerëve zbatues, prona intelektuale e prodhuar si rezultat i aktiviteteve menaxhohet në një mënyrë që maksimizon aksesueshmërinë e tyre nga publiku dhe mundëson përdorim sa më të gjerë të mundshëm.